



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 18.09.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË ZBATIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCave DHE EKONOMISË, DHE AGJENCISË GJERMANE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (GIZ), PËR PROJEKTIN “KËSHILLIMI PËR MIGRACIONIN NË SHQIPËRI”

1.0 Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 29.05.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për Emigracionin në Shqipëri”, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

1. Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin, znj. Dajna Sorensen, Zv ministër i Financave dhe Ekonomisë dhe Znj. Genta Prodani, Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë.

2.0 Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

3.0 Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

4.0 Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji ka për qëllim ratifikimin e kësaj marrëveshje e cila ka për objektiv forcimin e kontributeve të migrantëve për zhvillimin e vendeve të tyre të origjinës, përmirësimin e kushteve kuadër për migracionin e ligjshëm, luftimin e migracionit të parregullt përmes ofrimit të informacionit të nevojshëm për rrugët ligjore të migracionit të punës, rritjen e informimit lidhur me arsimin dhe formimin profesional e perspektivat e tregut të punës, si në Gjermani, ashtu edhe në Shqipëri.

Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin e Këshilli të Ministrave nr. 85, datë 14.02.2018 dhe është nënshkruar prej palëve.

Kjo marrëveshje bazohet dhe është në vijim të marrëveshjeve “Për bashkëpunim teknik” (21 tetor 1988) dhe “Për punësimin e punëtorëve për zgjerimin e njohurive të tyre profesionale dhe gjuhësore (10 dhjetor 1991) si dhe në rezultatet e bisedimeve në mars dhe korrik 2016, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë

Marrëveshja e zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri” ka për objektiv forcimin e kontributeve të migrantëve për zhvillimin e vendeve të tyre të origjinës, përmirësimin e kushteve kuadër për migracionin e ligjshëm, luftimin e migracionit të parregullt përmes ofrimit të informacionit të nevojshëm për rrugët ligjore të migracionit të punës, rritjen e informimit lidhur me arsimin dhe formimin profesional e perspektivat e tregut të punës, si në Gjermani, ashtu edhe në Shqipëri.

Këto objektiva do të ndiqen në mënyrë aktive në 5 fusha veprimtarie:

1. Këshillimin për politikën e migracionit, përmes një këshillimi të strukturuar politikash, që rrit koherencën politike, kapacitetin institucional për bashkëpunim si dhe dialogun.

2. Këshillimin për migracionin, rritja e mundësisë për marrjen e informacionit mbi rrugët ligjore të migracionit, për migrantët e mundshëm, informacionit mbi perspektivat e arsimimit dhe të punësimit në Shqipëri; informimit rreth migracionit të punës, mundësitë për hyrje në tregun gjerman të punës dhe trajnimet përkatëse për personelin e sporteleve të migracionit; gritjen e kapaciteteve të sporteleve ekzistuese, përmirësimin e bazës të të dhënave për aktorët në terren dhe situatën e grupeve të synuara.
3. Kthimi i migrantëve i orientuar nga zhvillimi duke mundësuar që migrantët e kthyer të kontribuojnë për zhvillimin e vendit të tyre përmes transferimit të njohurive.
4. Bashkëpunimi me diasporën.
5. Ide biznesi për zhvillim, përmes këshillimit efektiv të migrantëve për të zbatuar ide biznesi në vendin e origjinës.

Objektivat e sipërcituara, janë pjesë e programit global, “Migracioni për zhvillim” (PME), të autorizuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), të cilat, që prej 23 dhjetorit 2015 janë autorizuar të zhvillohen në Shqipëri. Gjithashtu këto objektiva janë në përputhje me masat e parashikuara në përparësinë strategjike A të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020.

5.0 Efektet financiare

Për elementin `kostot operative dhe administrative`, është përcaktuar edhe kontributi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) si struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e marrëveshjes. Ky kontribut do të jetë në masën 45 000 euro në vit për vitet 2019 dhe 2020, shuma këto të planifikuara në projektbuxhetin afatmesëm 2019-2021 dhe rishikimin e buxhetit të vitit 2018 brenda tavaneve buxhetore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ndërsa sa i takon kontributit gjerman për projektin, ai do të menaxhohet nëpërmjet GIZ-it, dhe për këtë qëllim qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t’i ofrojë GIZ-it deri në 1 500 000 (1 milion e pesëqind mijë) euro. Ky kontribut është i ndarë në 4 elementë si poshtë:

- i. Sigurimi i ekspertëve;
- ii. Furnizimi me materiale dhe pajisje;
- iii. Kostot operative dhe administrative;
- iv. Kontribute të tjera.

6.0 Diskutimet në Komision :

Deputetët në komision u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit bazuar në pyetjeve dhe përgjigjet e marra nga përfaqësuesit e ministrive. Deputetja znj. Gjebreja shtroi pyetje lidhur me mjetet që parashikon kjo marrëveshje në rastet e migrimit të paligjshëm, dhe trajtimit të

migrantëve. Pas sqarimeve nga përfaqësuesit e ministrisë, komisioni votoi dhe miratoi në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin.

7.0 Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për Emigracionin në Shqipëri”, është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshje ndërkombëtare.’”

Dhe konkretisht nenit 18 pika 3 në të cilën thuhet “Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2,të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi , me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI

